



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 05 Maj 2023

Nr: 438

Ora: 12:30

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 337 ID TË QENDRËS “QËNDRESA QYTETARE” PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATË 14 MAJ 2023**

Sot më datë 03 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Qendra “Qëndresa Qytetare”

**SUBJEKT:** Këshilli i Ministrave

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenit 91, pika 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me shkresë datë 17.04.2023, i administruar pranë nesh me shkresën nr. 3892 prot., datë 18.04.2023, nga Qendra “Qëndresa Qytetare” i regjistruar me nr. 337 ID ku pretendohet se, Këshilli i Ministrave ka miratuar një vendim, ku parashikohet shpërblim për pensionistat. Akti i mësipërm bie në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Data: 05 Maj 2023

Nr: 438  
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative”

**Denoncimi nr. 337 ID** “Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 187, datë 31.3.2023 “Për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023”. Në hyrje të këtij akti normativ përcaktohet se ai bazohet në “nenin 100 të Kushtetutës, në nenin 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 84/2022 ‘Për buxhetin e vitit 2023’”.

Sipas pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 31.3.2023 “Për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023”, shpërblimin, në masën 5000 lekë, të personave që përfitojnë këto kategori:

- i. personat që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;
- ii. personat që përfitojnë pension, sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;
- iii. personat që përfitojnë pension, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;
- iv. personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- v. personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANC-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;
- vi. personat që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm të caktuar në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- vii. personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/a ose 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- viii. *personat që nuk përfitojnë pension nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar të caktuar, sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar;*
- ix. *personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji";*
- x. *personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit financiar, si fëmijë në përkujdesje të Republikës, sipas ligjit nr. 129/2021, "Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës".*

*3. Sipas pikës 3, të vendimit, efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 3 536 735 000 (tre miliardë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë e ndarë në 3 508 665 000 (tre miliardë e pesëqind e tetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, për shpërblimin dhe 28 070 000 (njëzet e tetë milionë e shtatëdhjetë mijë) lekë shpenzime administrative për dhënien e shpërblimit. Kurse për efektet financiare, vendimi, parashikon se ato do të përballohen nga "Fondi i kontingjencës", miratuar në buxhetin e vitit 2023.*

*4. Vendimi nr. 187, datë 31.3.2023 "Për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023" ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 57, datë 3.4.2023."*

Denoncuesi pretendon se Këshilli i Ministrave, me nxjerrjen e aktit të mësipërm, ka shkelur nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3, të vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Neni 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua informacioni marrë nga denoncuesi.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 3.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Përfaqësuesi i qendrës “Qëndresa Qytetare” gjatë seancës parashitri edhe njëherë se:

*“Kjo VKM bie ndesh në kundërshtim të hapur dhe flagrant me nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet qartë se 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve, ndalohet propozimi, miratimi i akteve që synojnë apo favorizojnë apo shperblejnë, kategori të caktuara, ndër keto kateogri edhe kategoria e pensionistëve. Së pari nëse Këshilli i Ministrave, sikurse ka pretenduar edhe Kryeministri, do të ecin me interpretimin e nocionit të “qeverisë së re”, gjykojmë se duhet të përfshijë edhe qeverisjen vendore. Standardet demokratike të zgjedhjeve janë të njëjta, si për zgjedhjet vendore ashtu si për zgjedhjet e përgjithshme. Neni 91 nuk duhet të interpretohet në mënyrë të shkëputur dhe jo sistematike nga dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor, të cilat ngrejnë disa parashikime me qëllim ruajtjen e integritetit të zgjedhjeve dhe parandalimin e shpërdorimit të burimeve publike. Në të njëjtën kohë, sipas interpretimit të zgjeruar qeverisja e re duhet të përfshijë edhe nocionin e qeverisjes lokale. Edhe Kushtetuta e Shqipërisë bën një diferencim mes qeverisjes qendrore dhe qeverisjes lokale, duke përcaktuar në mënyrë të qartë se organet e njësisë së qeverisjes vendore janë bashkitë, komunat dhe qarqet. Secili prej organeve ushtron pushtetin që ka nëpërmjet organeve përfaqësuese, të cilat zgjidhen dhe konstituohen menjëherë pas zgjedhjeve. Në të njëjtën kohë, në interpretim dhe në frymë të ligjit është e qartë që gjithë Kodi Zgjedhor parandalon dhe ndalon përdorimin e asetëve publike, dhënien e shpërblimeve ndaj kategorive të caktuara gjatë periudhës 4 mujore, me qëllim mos favorizimin e një force të caktuar politike ose një subjekti të caktuar zgjedhor dhe parandalimin e këtyre fenomeneve dhe po ti referohemi vetë ndryshimeve dhe relacionit të Kodit Zgjedhor. Vetë kodi e ka bërë të qartë, që përdormi i burimeve publike duhet të ndalohet si në zgjedhjet lokale edhe në zgjedhjet e përgjithshme, sepse standardi i zgjedhjeve është i njëjtë. Zgjedhjet duhet të jenë demokratike, të lira dhe votuesit nuk duhet të jenë pjesë e presionit apo dhe trysnisë që bëhen në mënyra të ndryshme. Nëse do të ecnim në një interpretim të kundërt, do të pranohet fatkeqësisht një blerje vote masive nga ana e Këshillit të Ministrave, që kamuflohet përmes një vendimi apo akti normativ, duke i lënë hapësirën këtu një subjekti të caktuar politik, që ka edhe pushtetin politik dhe ushtron pushtetin ekzekutiv në të njëjtin kohë, për të blerë votuesit në mënyre masive.*

*Dhe për sa të gjitha sa thashë, duke i qëndruar Kodit Zgjedhor, Kushtetutës dhe frymës së ligjit, shpresoj që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të marrë një vendim, i cili do të ndalojë përdorimin e burimeve publike dhe do të krijojnë precedencë shumë të mirë për zbatimin ligjit, por dhe për integritetin e zgjedhjeve”.*

Në seancë u paraqit përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave, z. Herald Jonuzaj, i cili gjatë seancës u shpreh se “VKM është një akt në përputhje të plot me nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe me vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator. Përsa i përket pikës 4, të nenit 91 sikurse e citoj edhe denoncuesi, **4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re**, pra në Kodin Zgjedhor gjendet një ndarje e qartë e zgjedhjeve të përgjithëshme dhe zgjedhjeve vendore. Ndërkohë, pika 4, e Kodit Zgjedhor përcakton vetëm formimin e qeverisë së re, pra nënkupton zgjedhjet e përgjithshme. Pika 3, që është një riprodhim pothuajse i njëjtë i pikës 4, të nenit 91, që gjendet në vendimin e Komisionit Rregullator, është e njëjta dispozitë. Për të qenë më korrekt, Këshilli i Ministrave nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm me shkresën nr. 169/2 prot., datë 23 janar 2023, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të parë nëse është i aplikueshëm për zgjedhjet e përgjithëshme pika 4, e nenit 91 dhe pika 3, e nenit 3, të vendimit nr. 9, të Komisionit Rregullator. Nga përgjigja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 138/3 prot., datë 28.1.2023, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, sqarohet se nuk ndalohen veprimtaritë e parashikuara në pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu nuk ndalohen veprimtaritë e parashikuara në nenin 3, pika 3, dhe 5 të vendimit rregullator nr. 9, datë 24.12.2020. Përveç kësaj dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si institucion që është inicues dhe propozues i projektvendimit për dhënien e shpërblimit për pensionistët., me shkresën nr. 5857 prot., datë 29.3.2023, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të marrë mendimin e tyre nëse ky projektvendim bie në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe me vendimin nr. 9, të Komisionit Rregullator, gjithashtu edhe në kthimin e përgjigjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, konfirmohet se kjo veprimtari nuk është e ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”.

Pas administrimit të fakteve dhe provave të administruara nga ana e denoncuesit dhe të denoncuarit gjatë seancës publike, pasi u dëgjuan të gjitha pretendimet e palëve, vlerësojmë se, referuar nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se **“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”**.

Në qoftë se bëjmë leximin “fjalë për fjalë” të nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor, “deri në formimin e qeverisë së re” duket se legjislatori e kufizon “miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, që parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara” vetëm për zgjedhjet e përgjithshme për kuvend.

Sa më sipër, në mungesë të një dispozite ndaluese, nxjerrja e kësaj kategorie aktesh për zgjedhjet vendore, nuk mund mund të jenë objekt shqyrtimi për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Palët në këtë proces nuk mund të procedohen për miratimin e akteve, që në momentin kur janë nxjerrë, nuk janë parashikuar nga Kodi Zgjedhor si shkelje administrative. Në këtë kuadër, miratimi i këtyre akteve prej të denoncuarit mbetet brenda parashikimeve të ligjit.

Për sa më sipër në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjate procesit administrativ, rezulton se objekti për këto denoncime nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S:**

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Këshillit të Ministrave.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**